



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:132220
Datë: 13.12.2024
Numri i dokumentit: 06593960

CA.nr.5892/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.A, F.K dhe B.B, që të gjithë nga P....., të cilët me autorizim i përfaqësojnë N.M dhe D.Sh, avokatë nga P....., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh, për kompensimin e ushqimit-shujtave gjatë ditëve të punës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2099/23, të datës 17.01.2024, të mbajtur me datë 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2099/23, të datës 17.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.2099/23, të datës 17.01.2024, ka vendosur si në vijim: “ *I APROVOHET kërkesëpadia e paditësve A.A, F.K dhe B.B, që të gjithë nga P....., në tërësi si e bazuar. II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të shujtave ditore, ti paguaj shumat si në vijim:*

- *Paditëses A.A, në emër të shujtave ditore, për 145 ditë pune (nga data 01.02.2022, deri me datën 21.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, apo shumën e përgjithshme prej dyqind e nëntëdhjetë euro (290.00 €);*

- *Paditësit F.K, në emër të shujtave ditore, për 145 ditë pune (nga data 01.02.2022, deri me datën 21.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, apo shumën e përgjithshme prej dyqind e nëntëdhjetë euro (290.00 €);*
 - *Paditësit B.B, në emër të shujtave ditore, për 145 ditë pune (nga data 01.02.2022, deri me datën 21.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, apo shumën e përgjithshme prej dyqind e nëntëdhjetë euro (290.00 €);*
-të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, për secilin paditës e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.06.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- I.** *DETYROHET e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej dyqindtridhjetetë euro (228.00€), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm”.*

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes të autorizuarës të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovojë ankesën e të paditurës, të prishet aktgjykimi i atakuar dhe të hedhet poshtë padia e paditësit dhe çështja kontestuese ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala paditëse përmes të autorizuarit të tyre, të cilët kanë propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pa themeltë dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi me datë 13.06.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës, me objekt të padisë kompensimin e shujtave, ndërsa me parashtruesën e datës 31.10.2023, paditësit përmes të autorizuarve të tyre kanë bërë precizimin e kërkesëpadiës, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që paditësve të i kompensohen shujtat ditore nga data 01.02.2022 e deri me datë 21.11.2022, për paditësit A.A, F.K dhe B.B, nga 145 ditë pune, në lartësi prej 290.00 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e parashtrimit të padisë në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit të shkallës së parë si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës në kuptim të nenit 152 të LPK-së, jashtë seance ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2099/23, të datës 17.01.2024, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht pranë SHFMU "F..... B....." në P..... Nga vërtetimi me numër 289/23, i datës 16.10.2023 të lëshuara nga drejtori i shkollës të SHFMU "F..... B....." në P....., gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.A, nga P....., është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2022, dhe atë nga data 01.02.2022 e deri me datë 21.11.2022, kanë punuar gjithësej 145 ditë pune. Nga vërtetimi me numër 302/23, i datës 16.10.2023 të lëshuara nga drejtori i shkollës të SHFMU "F..... B....." në P....., gjykata vërtetoi faktin se paditësi F.K, nga P....., është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe i njëjti për vitin 2022, dhe atë nga data 01.02.2022 e deri me datë 21.11.2022, kanë punuar gjithësej 145 ditë pune. Nga vërtetimi me numër 295/23, i datës 16.10.2023 të lëshuara nga drejtori i shkollës të SHFMU "F..... B....." në P....., gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.B, nga P....., është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe i njëjti për vitin 2022, dhe atë nga data 01.02.2022 e deri me datë 21.11.2022, kanë punuar gjithësej 145 ditë pune. Andaj gjykata secilit paditës vendosi, duke ia njohur shumën si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Për bazën juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ku përcaktohen të drejtat e të punësuarve për kompensimin për ushqim gjatë punës, lidhur me këtë iu referua nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së dhe bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në nenin 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e administruara dhe zbatimin e të drejtës materiale.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), se nuk ka dhënë arsye bindëse për faktet vendimtare, nuk ka paraqitur qartë se cilat arsye i trajton si të vërteta apo të pavërteta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto pretendime të autorizuarit të paditurës janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Lidhur me pikën o) të nenit 182.2 të LPK-së në të cilën thirret pala e paditur duke mos cekur se në cilat raste është tejkualuar kërkesëpadia dhe duke mos cekur arsyet e saj për tejkualim të kërkesëpadiës, ndërsa kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk e ka tejkualuar kërkesëpadiën, por ka vendosur brenda kufijve të kërkesave të palës paditëse, e sipas petitumit të padisë së saj.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht pranë SHFMU “F..... B.....” në P..... Nga vërtetimi me numër 289/23, i datës 16.10.2023 të lëshuara nga drejtori i shkollës të SHFMU “F..... B.....” në P....., gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.A, nga P....., është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2022, dhe atë nga data 01.02.2022 e deri me datë 21.11.2022, kanë punuar gjithsej 145 ditë pune. Nga vërtetimi me numër 302/23, i datës 16.10.2023 të lëshuara nga drejtori i shkollës të SHFMU “F..... B.....” në P....., gjykata vërtetoi faktin se paditësi F.K, nga P....., është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe i njëjti për vitin 2022, dhe atë nga data 01.02.2022 e deri me datë 21.11.2022, kanë punuar gjithsej 145 ditë pune. Nga vërtetimi me numër 295/23, i datës 16.10.2023 të lëshuara nga drejtori i shkollës të SHFMU “F..... B.....” në P....., gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.B, nga P..... është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe i njëjti për vitin 2022, dhe atë nga data 01.02.2022 e deri me datë 21.11.2022, kanë punuar gjithsej 145 ditë pune, e për të cilën periudhë kërkojnë kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se: Me nenin 90 par. 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 4 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”.

Ndërsa nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 është përcaktuar se: “*Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimi për një ditë të pranisë në punë është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë formë tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin*”. Andaj edhe për vlerën për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, me të drejtë iu është njohur shuma totale secilit paditës nga 290.00 €.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “*MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9.*”

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtës ditore) gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se e paditura nuk ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit, pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e këtyre kontratave me ç‘rast të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e datës 22.01.2021 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit bie mbi të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë del të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale të referuar për këtë çështje juridike kontestuese nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelësinë e kërkesëpadisë.

Vendimi mbi kamatën është vendosur konform nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr.265/2020 i datës 01.12.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:132220
Datë: 13.12.2024
Numri i dokumentit: 06593960

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.5892/2024, me datë 12.12.2024

Kryetare e kolegjit - gjyqtare
Nora Bllaca Dula, d.v